



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-18304/19
Kaçanik, 28.06.2019

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VI (Gjashtë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur me, 28 Qershor 2019. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 25 anëtarë, në ndërkohë arriti anëtari, Hamid Guri, kështu që pjesëmarrës të këtij takimi konstatohet së ishin 26 anëtarë. Në mbledhje mungoj me arsye, anëtari, Sali Malsiu.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive: Ramadush Osmani, Bahri Selimi, Fatmir Loku, Ukshin Qallaku, Festim Neziraj dhe Diana Reka. ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Iliriana Berisha, Arbnora Kuka, Fatlume Selimi dhe Kefsere Koxha.

Mbledhja u monitorua përmes. Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Makfite Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin duke i thirrur emër për emër të gjithë anëtarët e KK. Pjesëmarrës në mbledhje janë, 25 anëtarë, ndërkaq 1 anëtar pritët të vijnë në ndërkohë, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi Mbledhjen e VI të Rregullt të Kuvendit të Komunës, për vitin 2019, data 28 Qershor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Draft- Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e Komunës së Kaçanikut për vitet, 2020-2022;
3. Draft Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Kaçanikut;
4. Debatim për çështjen e një kyçje - çkyçje në Autostradën "Arben Xhaferi" si dhe çështjen dëmtimit të rrugëve lokale nga "Bektel Enka";
5. Rishqyrtimi i Vendimit 01Nr. 104/02-0013023/19- Për dhënien në shfytëzim afatgjatë të Parcelës Kadastrale Nr. 00217-0, ZK Gërlicë e Epërme, kompanisë N. T " X -PLAST, në emër të Nexhat Vogliqi;

6. Rishqyrtimi i Vendimit 01Nr.104/02-0013410/19- Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të Parcelës Kadastrale Nr. 00124-0 Zona Kadastrale Doganaj dhe Parcelën Kadastrale Nr.00217 Zona Kadastral Gërlicë e Epërme, kompanisë NTP ‘ Muja’ me pronarin Muhamet Zenuni;
7. Propozim Vendimi për lidhjen e Marrëveshjes së re lidhur me qëndrim pa pagesë të automjeteve dhe të masës drusore të konfiskuara në Autoparkun e SHIL.
8. Propozim Vendimi për formimin e Komisionit të Ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim.

Lidhur me rendin e propozuar të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë, Rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Rendin e Punës në përbërje prej 7 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës:

Procesverbali i mbledhjes së V-të (Pestë) të Rregullt i Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja e V-të (Pestë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2019 të datës 30 Maj 2019. / Lënda: 01Nr. 60/01-15123/19.

Kryesuesi i Kuvendit, Para se me kaluar në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave, kërkoj nga shërbimet përkatëse të merren veprime të nevojshme për rregullimin e incizimit të mbledhjeve, sepse dy mbledhjet e fundit nuk janë online në Faqen Zyrtare të Komunës.

Pyetje dhe Kërkesa

z. Ekrem Kyçyku, Unë kam një Kërkesë në emër të 5 barnatoreve të cilat veprojnë në Komunën e Kaçanikut lidhur me ngarkesat komunale të përcaktuara me rregullore. sipas shkresës së tyre thuhet janë të ngarkuar me është taksë vjetore të lartë në raport me disa biznese të tjera si ordinancat mjekësore, stomatologjike, rëntgen-et, laboratorët, poliklinika etj. ndërkaq të disa veprimtari është hequr apo ulur taksa komunale. Kërkesa tyre është të ulët ngarkesa vjetore e tyre nga 250 € të ulët në150€, ndërkaq pos tjerash, kanë shprehur shqetësimi së nuk e kanë marrë ende ngarkesën vjetore për vitin 2019. Kërkesa u lexua nga Ekrem Kyçyku, ndërkaq e njëjta iu përcoll Shërbimit të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Rregullorja e tarifave dhe ngarkesave është votuar në KK dhe i vetme ky organ mund ta ndryshoj dhe plotësoj, andaj Kërkesa është dashur me ia adresuar Kuvendit të Komunës.

Kryetari i Komunës, Është mirë që paraqitën shqetësimet si kjo e barnatoreve për çështje të caktuara e të ngjashme, mirëpo duhet të analizohen të njëjtat. Të Çështja e tarifave të barnatoreve, barnatoret janë profitabile, ndërkaq Rregullorja e tarifave dhe ngarkesave është miratuar në Kuvendin e Komunës dhe kjo çështje mund të diskutohet nga ky organ dhe të shikohet sesa janë të arsyeshme shqetësimet e tyre.

z. Ekrem Kyçyku, Ne i përcjellim shqetësimet e qytetarëve të cilat na janë adresuar. Të çështja e tarifave dhe ngarkesave të barnatoret, ne e kemi vërejtur se nuk janë taksat e barabarta me disa veprimtaritë tjera shërbyese.

Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës mund të propozoj taksa, por vendimin e merr kuvendi. E drejta e secilit është me ngritur shqetësime të qytetarëve, por jo me qenë tendencioze, ndërkaq taksat mund të shqyrtohen në Kuvendin e Komunës.

znj. Nazife Krasniqi, Pyetje për DSHPE: Sa jeni të përgatitur për temperaturat e larta të cilët pritet të mbretërojnë sivjet? A ka ndonjë Plan për çështjen e menaxhimit të zjarreve nëse paraqiten rastet? Cilat janë veprimet të cilat do të merren për mungesën e ujit të pijes? A jeni të përgatitur për çështjen e parkingjeve, kur dihet se tani në këtë sezone shtohet numri i popullatës me ardhjen e bashkatdhetarëve?

z. Adnan Reka,

1. A mund të na sqaroni çështjen e festivalit Kaçaniku 2019 dhe shumën 8500 €. E para, a është e vërtetë se Komuna ka ndarë 6000 € dhe Ministria e Kulturës 2500 € për këtë festival, nëse Po, si u shpenzuan të gjitha këto para? Dhe e dyta, si guxojnë zyrtarët Komunal të lejojë që shërbimet për këtë festival të paguhen me para në dorë 'kesh' bile edhe pa asnjë faturë.

2. Duke konsideruar temperaturat e larta që pritet ta përfshijnë edhe në vendin tonë, kërkojmë që me kohë të bëhet dezinfektimi i territorit të Komunës, gjithnjë duke pasur parasysh numrin e madh të deponive ilegale të mbeturinave që janë, dhe pasojave para të cilave gjendemi.

Znj. Arlinda Rakoci-Raka, Kam një Kërkesë për DSHPE lidhur me pllakën të Shtëpia e Kulturës, e cila pllakë ka gabime teknike dhe e njëjta duhet të përmirësohet. Në pllakë është shënuar "Shtëpia: ndërkaq duhet të jetë, "Shtëpia".

z. Bekim Koxha,

1. Më intereson të di, çka është ndërmarrë nga inspektorët të komunës për ndotjen e lumit Lepenc nga kompania "Bubeari".

2. Të Objekti ndërtimor me lokale afariste, se pari janë vendosur shkallë nga zyrtari komunal që shet tepija e pastaj vendosja e shkallëve ka filluar me barnatoren e cila ende iu shërben pacienteve përmes dritareve me barna si me qenë trafikë. A kanë leje këta persona që kanë vendosur shkallë duke shkelur ligjin, e sidomos kur këto veprime i bënë zyrtari komunal?! A keni marrë masa në këtë drejtim? A ka inspektor ndërtimi komuna dhe kush i kontrollon këto punë që janë duke u bërë në terren pa kurrfarë përgjegjësie?

3. Kërkoj një sqarim nga DAK, përse nuk ka pasur organizim për testin kombëtar, kur dihet së nxënësit kanë paguar nga 5 € si pasojë e mos organizimit, ndërkaq një nxënës atë ditë ka humbur se nuk e ka ditur terrenin.

4. Pse nuk ka ujë në ujësjellësin e f. Doganaj, ndërkaq në f. Elezaj nga vjen drejtori ka ujë. Ka shqetësime se drejtori manipulon me çështjen e ujësjellësit.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kërkesa të tjera, përgjigjet do t'i merrni nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhjen vijuese të Kuvendit të Komunës, atëherë procedojmë me pikët e radhës të rendit të punës;

2. Draft- Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e Komunës së Kaçanikut për vitet, 2020-2022;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, para se më hapur diskutimin në këtë pikë, fillimisht fjalën e ka drejtori i DEFZH, Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, Sqaroj për draftin kornizë, shumën e projektuar për secilin vit buxhetor, ku për vitin 2020, janë projektuar gjithsej: 9,000,531.00€, 9,315,958.00€ në vitin 2021 dhe 9,660,090.00€ në vitin 2022, duke i potencuar burimet e financimit, krahasimet me vitet paraprake, grantet specifike për arsim dhe shëndetësi Investimet sipas programeve shpenzuese buxhetore, ndërkaq shtoj së shuma e Investimet Kapitale (IK) do të arrijë shuma 21-25% e buxhetit të planifikuar për vitet 2020-2022 për 56 projekte me shumat, 2,255.000€ në vitin 2020, 2,305.000€ në vitin 2021 dhe 2,545.000€ në vitin 2022. Kategoria e IK do të jetë me pjesëmarrje.

Në vazhdim drejtori sqaroj edhe për të HVK, 710,727.00€ në vitin 2020, 769,995.00 në vitin 2021 dhe 829,328.00€ në vitin 2022, krahasimet nga viti në vit, burimet e krijimit të hyrave përfshirë edhe tatimin në tokë, ndërkaq shtoj së në bazë të Rregullores së tarifave që do të miratohet, ndërmarrjet prodhuese me karakter punësimi nuk do të paguajnë, ndërkaq ato veprimtari që nuk janë shërbyese kanë me paguar tarifa dhe ngarkesa. Jemi duke bërë analiza në këtë drejtim, sesi me bërë Planin e tarifave për bizneset.

z. Ekrem Kyçyku, Të çështja e barnatoreve, esenca është që me u barazuar taksat e barnatoreve me veprimtaritë tjera shërbyese të karakterit të njëjtë. Sa i përket dokumentit KAB për vitet 2020-2022, shihet se nuk garanton zhvillim ekonomik të vendit. Tjetër, ka gabime në tekst, si fjala vjen shënohet, liqeni i Dinaricës, ndërkaq duhet të jetë liqeni i Gjollit,

Të Bujqësia- sektori më kryesor, shihet se janë ndarë në vitin 2020, 50.000€, 70.000€ në vitin 2021 dhe 90.000€ në vitin 2022. Unë nuk e di si mundet me u zhvilluar bujqësia me këto mjete buxhetore të ndara. Të Turizmi, edhe këtu ka pak mjete buxhetore të ndara, ndërkaq si komunë shihet se nuk i kushtohet shumë kësaj sfere. Kjo u pa në rastin e vizitës që i bëmë Shoqata e Bjeshkatarëve fshatit Shtrazë, dhe mysafirë të ftuar të komunave të tjera të Kosovës, ku ishte edhe TV Chanel, ndërkaq nuk na lejuan me qëndruar aty nga kryetari i fshatit Shtrazë.

z. Selim Reka, Të Investimet, unë mendoj se duhet pasur përparësi projektet me prioritet, si: Çështja e ujit të pijes, kur kemi lagje apo vendbanime që kanë mungesë të ujit të pijes. Të Subvencionet të bujqësi, mendoj se duhet qytetarëve që përfitojnë nga subvencionet në bujqësi, t'iu ofrohet shërbim profesional (asistencë) Të infrastruktura, mund të lidhemi edhe me turizmin, ashtu që e kemi Sallën e vogël të Shtëpia e kulturës "Xheladin Kurtaj" në Kaçanik, në gjendje të rëndë. Kjo sallë është mirë të rinovohet, dhe kishte me qenë atraksion me u vizituar kjo sallë – monumenti ku u shpall Kushtetuta e Republikës së Kosovës me 7 Shtator 1990. Tjetër, Pjesa të Guri i Shpumë dhe Gryka e Kaçanikut të lidhen me trotuar deri në Han të Elezit për këmbësor dhe biçikleta. Të vazhdohet shtrimi më gurë i Lumit Lepenc, duke filluar pjesa nga Shtërpea nga pjesa ku është në territorin e komunës tonë, ndërkaq mos të pengohen ujëtja e kulturave bujqësore.

Të Arsimit, të investohet në infrastrukturë shkollore dhe krijimin e kushteve teknike e teknologjike të klasave në shkolla.

z. Shpend Krusha, Në F. 5, unë kam një kërkesë, të pjesa ku thuhet se ka përfunduar projekti nacional i autostradës " Arbën Xhaferi" është dashur me u potencuar se një hyrje-dalje në qytetin e Kaçanikut kishte me ndikuar në zhvillimin ekonomik të vendit.

Shkëputja e Komunës tonë nga Hani i Elezit, dhe gjiganti " Sharr Cem" është e vërtetë se ka ndikuar në ngecjen e zhvillimit të vendit, mirëpo nuk është cekur se ka ndikuar në ngecjen e zhvillimit ekonomik, mbyllja e fabrikës së Gëlqeres në Kaçanik.

Turizmi malor, duhet zhvillohet në të ardhmen dhe me investuar në këtë lëmi. Këtu duhet të përfshihet edhe turizmi kulturor, ashtu që të bëhet ndërtimi i një Muzeu, ku mbledhen të gjitha artefaktet për historinë e Komunës së Kaçanikut, dhe ky muze do të vizitohet nga vizitorë nga qytetarë të Republikës së Kosovës dhe qytetarë nga shtete tjera. Është mirë kjo çështje të inicohet në Ministrinë e Kulturës, sepse ndërtimi i një objekti muze në Komunën tonë e nxitë turizmin, ndërkaq dihet se edhe zhvillimi i turizmit ndikon në zhvillimin ekonomik të vendit.

z. Ekrem Raka, Unë nuk e shoh zhvillimin ekonomik në infrastrukturë rrugore etj. por në projekte më prioritet, e jo me u shpenzuar buxheti në interes të 5 apo 6 shtëpive.

Të Sektori i Bujqësisë, shihet se janë planifikuar 50.000€ në vitin 2020, e që i bien së janë paraparë mjete buxhetore sa një projekt me prioritet i një fshati apo vendbanimi. Ju e keni pushtetin (fjala është për subjektet politikë në pozitë), i keni votat dhe mundeni me vazhduar me prioritet ashtu si doni ju vet, por duhet pasur parasysh faktin se në sistemin demokratik, pushteti duhet të matet me ndarjen dhe shfrytëzimin e drejtë të buxhetit të komunës.

z. Bekim Koxha, Unë shpreh shqetësimet e mia për shumatat e ndara në sektorin e Bujqësisë, 50.000€ për zhvillimin e bujqësisë dhe 30.000€ për zhvillimin e turizmit. Këto shumata janë të vogla dhe nuk mund të bëhet asgjë në këta dy sektorë. Gjatë tërë fushatës premtori projekte për bujqësinë dhe turizmin, ndërkaq kur të vjen koha, ndani atë shumata të vogla sa që më ato shumata të ndara, nuk mundesh më bërë asgjë në zhvillimin e këtyre dy sektorëve. Të prioriteti, z. Koxha identifikoj disa projekte që kanë hyrë në listë për rregullimin e infrastrukturës rrugore dhe të kanalizimeve, ku janë paraparë shumatat nga 5.000€, të cilat projekte theksoj se nuk mund të realizohen me shumatat e ndara. Edhe të Zonat Industriale, shumata e ndarë për ndërtimin e infrastrukturës së këtyre zonave është e vogël.

Kryesuesi i Kuvendit, Ky është leximi i parë i buxhetit, KAB ka edhe procedura të tjera të shqyrtimit, ndërkaq duhet të kontribuoni në këtë dokument ashtu që të hiqet një projekt me prioritet dhe të shtohet një tjetër, e jo vetëm të jepni vërejtje.

znj. Lirije Luta, E përgëzoj drejtorin për punën dhe përkushtimin e tij që ka bërë në përpilimin e këtij drafti, ndërkaq subjekti LVV sa herë flasin me tendencë drejtuar Kryetarit të Komunës. Duhet ta kemi parasysh faktin se Kryetari i Komunës tonë, Besim Ilazi është zgjedhë kryetari më transparent për aktivitetin e komunës.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Pajtohem me gabimet teknike në draft, ndërkaq të çështja e f. Shtrazë lidhur me vizitën e Shoqatës së Bujshkatarëve, shqetësimet e fshatit kanë qenë më vend dhe të argumentuara për dëmtimet të cilat u janë bërë vitin e kaluar. Kështu për hire të qetësisë është kërkuar me u mbajte në Ivajë.

KAB, është drafti fillestar, ky buxhet është ky që është. Ne për KAB e mbajtem një Dëgjim publik me qytetarë, ndërkaq sot është leximi i parë i tij. KAB ka edhe procedura të tjera ku mund të adresohen prioritetet. Kur është fjala për infrastrukturën rrugore, ka njerëz të cilët ende ecin nëpër baltë dhe është e nevojshme atyre qytetarëve më iu krijuar infrastrukturën rrugore. Për Muzeun, pajtohem që kjo çështje të jetë në rend pune në një takim të KK. Për buxhetin e ndarë për bujqësi, janë pak 60.000€, mirëpo në vitin e kaluar ishte 150.000€. Subvencionet ndahen për kokë të banorit, dhe të bujqësia hyn edhe subvencionet, kanalet e

ujitjes etj. Gjithçka që debatoni është mirë të argumentoni, ndërkaq nëse ju thoni se nuk ka nevojë për ndonjë projekt, ne e heqim, por jepni opsionet se ku duhet shkuar ai projekt.

z. Nexhat Loku, Unë kam qenë pjesë e dëgjimeve publike të organizuara me qytetarë të komunës dhe kërkesat e mia i kam ngritur në dëgjime publike, ndërkaq edhe ju keni qenë të obliguar të merrni pjesë. Të projekti për zhvillimin e turizmit, është hera e parë që ka hyrë ky projekt në prioritet dhe është mirë që ka hyrë sepse komuna jonë ka potencial ka vende turistike dhe ato vende duhet të zhvillohen për me nxitur vizitorë me i vizituar. Zhvillimi i turizmit normal së ndikon në zhvillimin ekonomik të vendit.

z. Besim Vishi, Nëse rrezikohet ujijtja e tokave në f. Provoli, nuk është dashur më shënuar. Ujijtja e tokave ndikon në zhvillimin e bujqësisë. Është mirë me ditur se ku po ndërtohet ai hidrocentral, ose kisha thënë më u ndërtuar diku në periferi nënstation 110 FAW. Nëse e ndërtojmë këtë rrjet afër Silçaporit, do të ishte shumë më e favorshme sesa me i dëmtuar ujitjen e pronave bujqësore. Të projektet kapitale e pashë disa nga to si në listë ishin të përgjithshme, kështu është mirë me u konkretizuar të njëjtat.

z. Ekrem Kyçyku, Për anëtarët e PDK: Nuk ka nevojë me e mbrojtur Kryetarin e Komunës, sepse unë kam raporte dhe njihem me herët me familjen e kryetarit, mirëpo në politikë jemi ndryshe këtu.

znj. Nazife Krasniqi, Kaçaniku është qyteti me i bukur në Kosovë, me natyrë shumë të bukur, por duhen mjete buxhetore me i mirëmbajtur ato bukuri natyrore, dhe kjo nuk është bërë të ne, kështu që duhet investuar me ia shtuar bukurinë qytetit. Të Investimet kapitale, pa një Plan rregullues të mirëfilltë të Kaçanikut nuk mund të bëhen projekte të mira. Këtë e themi sepse, banesat janë pa parkingje, qyteti pa hapësira gjelbëruese.

Lagja "Dushkaja" e ka pasur një Plan me bukuri gjelbëruese, mirëpo edhe ajo lagje ka filluar me u degraduar.

Të Tabela 4.3. të HVK janë zvogëluar në vitin 2019 dhe 2020, pse ndodhë kjo, kështu të certifikatat është një diferencë e madhe.

Të Investimet Kapitale, duhet shikohet numri i personave që përfitojnë nga realizimi i atij projekti, si të projektet shkollore etj.

Shkolla " Emin Duraku" nuk ka hyrë në prioritet me u rehabilituar. Në Draft Buxhet nuk janë paraparë me u ndërtua ndonjë çerdhe e fëmijëve.

z. Bekim Koxha, Derisa po hartohet Planet zhvillimore, ndërkaq nuk janë paraparë me u bërë hartat zonale. Unë nuk e di kush i jep ato leje ndërtimi në kundërshtim me PZH të Komunës, si leja e ndërtimit të objektit të Shëllqja si dhe një objekti ndërtimor me lokale afariste i cili është duke u ndërtuar. Ndërtimet të cilat janë duke u bërë në rrugën "Ismajl Raka", në Kaçanik, janë duke dalë gati në trotuar, e që këto ndërtime janë në kundërshtim me PZHU, për këtë zonë, i cili plan ende është në fuqi, derisa nuk punohet plani tjetër që e shfuqizon këtë plan. Pse po lejoni me u ndërtua objekte kur nuk keni kryer planet zhvillimore komunale, pse po lejoni me u prishur gjendja në teren ? Ku është harta zonale e komunës që është paguar që dy vjet ? Qysh po lejoni me bërë ndërtime kontrum? Pse nuk e pritni me u bërë plani i ri e pastaj me u lejuar ndërtimet si e parasheh plani.

Pse nuk e respektoni Planin e vjetër, ku sipas tij nuk lejohen këto ndërtime, qysh është duke vepruar DUKMM ? Për të gjitha këto që i potencova, kërkoj sqarime nga drejtori i urbanizmit.

z. Hajredin Luta, Në Kaçanik, problem është çështja e parkingjeve. Gjithashtu duhet të rregullohet shëtitorja nga këtu e deri të ambulanca me tre shirita, një të shërbejë për parkingje të automjeteve dhe 1 shirit të shërbejë për intervenime në raste emergjente

z. Bahri Selimi, Sqaroj për pyetjet të cilat u ngritën, të TP theksoj së se me Ligjin e vjetër zbritja ka qenë 10.000€ e pronave të banimit, ndërkaq me Ligjin e ri është 15.000€. Të Sektori i Arsimit të Tabela 4.1. janë ndarë 220.000€ për IK në shkolla nga Granti për arsim, dhe kjo ndarje është bërë në bazë të numrit të nxënësve të shkollave të komunës, ku do të bëhen renovime të shkollave, ndërtim të çerdhe për fëmijë. Pjesë përbërëse e komunës është strategjia zhvillimore e komunës. Të çështja e mjeteve të ndara për bujqësi, duhet ta keni parasysh se shumica është e vogël e ndarë për këtë sektorë, por bujqësia përkrahet edhe nga subvencionet.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Draft Kornizën Buxhetore e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 12 votë Për, 7 votë Kundër, Abstenuan 5. Prezent në mbledhje kur u votua kjo çështje ishin 24 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës me shumicë të thjeshtë e, mori,

VENDIM

Për Aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Kaçanikut për vitet, 2020-2022; dhe e njëjta lëshohet në procedurë të debatit publik me qytetarë / Lënda: 01Nr. 05-400/01-18025/19.

3. Draft Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Kaçanikut:

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, për sqarime të nevojshme është prezent drejtori i drejtorisë. Nëse ka kush diçka e hap diskutimin:

z. Bekim Koxha, Unë si anëtarë i KK kërkoj që mërgimtarët mos të paguajnë në formë paushalli mbeturinat e amvisërisë, pasi që nuk qëndrojnë më tepër se 1 muaj në Kosovë, dhe një pagesë e tillë në shumë 20 euro, për mendimin tim është harra për ta. Të caktohet një lokacion apo dy lokacione për hedhjen e mbeturinave të ngurta të cilat krijohen nga prishjet apo ndërtimet e shtëpive etj.

z. Selim Reka, Për mendimin tim kjo Rregullore është më tepër e dëshirueshme me pasur sesa është e zbatueshme. Unë kërkoj që të futën në sistem të gjitha ekonomitë familjare etj. që krijojnë mbeturina, e jo të hedhen mbeturina vend e pa vend. Gjithashtu duhet të përcillen hedhësit ilegal të mbeturinave.

z. Ekrem Kyçyku, Unë nuk kam diçka me shtuar, vetëm uroj që kjo Rregullore të gjënë zbatim në praktikë.

z. Adnan Reka, Theksoj së Rregullorja është e vonuar drejtor ! Është dashur moti të kemi rregullore për menaxhimin e mbeturinave. Derisa Komunat tjera ka kohë që kanë rregullore edhe atë funksionale për menaxhimin e mbeturinave (Prishtina 2016, Podujeva 2015), ne deri tani as rregullore nuk kemi. Pyetja është, si do të bëhet mënjanimi i të gjitha atyre deponive ilegale, duke pasur parasysh se ato deponi janë në teren mjaft të vështira, dhe që nuk po ndërmerret asgjë për parandalimin e tyre?

z. Besim Vishi, Të nenit 7, Të te drejtat dhe detyrimet e gjeneruesve, duhet të potencohet se çdo gjenerues duhet t'i ndanë mbeturinat sipas llojit.

z. Ramadush Osmani, Të neni 4.4 është sqaruar për çështjen e deponive inerte. Kjo do të caktohet me vendim të Kryetarit të Komunës. Jemi në hulumtim të lokacionit për deponi inerte (mbeturina të ngurta).

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Draft Rregulloren e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori.

VENDIM

Për Arovimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Kaçanikut / Lënda: 01Nr. 07-60/01-17890/19.

Pas përfundimit të kësaj pike, Kryesuesi i Kuvendit kërkoj të bëjë një pausë të KK për 10 minuta. Pas pausës 10 minutëshe, KK u kthyer në sallë për shqyrtimin e pikave të tjera të mbetura: Pjesëmarrja e anëtarëve të KK pas pasuës ishte 23 anëtarë. Kryesuesi i Kuvendit konstatoj me vazhduar me pikët e mbetura sipas rendit të punës:

4. Debatim për çështjen e një kyçje - çkyçje në Autostradën "Arben Xhaferi" si dhe çështjen dëmtimit të rrugëve lokale nga "Bektel Enka";

Kryesuesi i Kuvendit, Kjo Kërkesë ka rrjedhë nga mbledhja e kaluar për me u debatuar. Fillimisht fjalën e ka anëtari nga LVV, Shpend Krusha, pastaj e marrin fjalën të interesuarit tjerë.

z. Shpend Krusha, Kjo çështje është iniciuar nga LVV, ndërkaq është mbështetur nga të gjithë anëtarët e KK, me çka iu drejtim me një shkresë nivelit qendror, mirëpo çështja nuk ka shkuar deri në fund. Ndërtimi i një kyçje ç kyçje në qytetin e Kaçanikut do të ndikoj në zhvillimin ekonomik të komunës, ndërkaq është mirë të shfrytëzojmë këtë moment, pasi që dy komuna edhe pasi u lëshua në qarkullim autostrada, e morën mbështetjen nga organet relevante për lejimin e nga 1 kyçje ç kyçje në autostradë. Çka duhet bërë ne shtrohet pyetja? Ose duhet me organizuar një delegacion në emër të komunës tonë më shkuar e më biseduar me mekanizmat relevantë të nivelit qendror ose versioni i fundit është me u ngritur në protesta.

z. Bekim Koxha, Unë e përkrahi këtë iniciativën për me iu drejtua me një Kërkesë Kryeministrit dhe Ministrit së linjës për lejimin e një kyçje ç kyçje në autostradë, sepse qyteti i Kaçanikut ka nevojë për me pasur afër qasjen në autostradë.

z. Adnan Reka, Në mbledhjen e II të KK, 2018, Nexhati kishte kërkuar që të formohet një Komision i përbërë nga anëtarë të Kuvendit dhe të Ekzekutivit për përcjelljen e punimeve dhe vlerësimin e dëmeve që po shkakton Bechtel Enka gjatë ndërtimit të autostradës dhe në njëzëri e kishim aprovuar. Unë në mbledhjen e V të KK, në maj 2018, kisha kërkuar të di për fatin e atij Komisioni, por kurrë nuk kam marrë përgjigje.

Shpendi qysh në mbledhjen e VI të KK, 2018, (rrafsh para një viti) kishte kërkuar që në mbledhjen e radhës të debatohet për të njëjtën temë që po debatojmë sot, kyçja në autostradë, pastaj Shpendi kishte bërë edhe një kërkesë me shkrim për këtë gjë dhe është kërkuar të formohet një grup punues nga Kuvendi që çështjen e kyçje në autostradë ta ndjek deri në fund. Në seancën e kaluar Nexhati kishte kërkuar që në seancën e radhës (sot) të debatohet për autostradën, dhe kërkesa aprovohet menjëherë. Në anën tjetër, ju vetëm formalisht (sa me shpërla gojën) na ftoni për bashkëpunim në të mirë të qytetarëve, por unë them që, ne

opozita është më mirë të mos kërkojmë asgjë, se çfarëdo që ne kërkojmë dhe pavarësisht sa e drejtë dhe e nevojshme është, ju nuk keni vullnet ta përfillni kërkesën e pozitës.

Më tej, ju thoni se kërkesën e KK ja keni përcjellë Ministrisë së linjës, dhe ata kanë thënë se nuk ka mundësi tjetër të kyçje në autostradë për Komunën e Kaçanikut. Athua a kaq formale qenka kjo puna e kyçje në autostradë sa të kërkojmë vetëm përcjelljen e kërkesës për ministri, kur kemi mijëra qytetarë të Komunës së Kaçanikut që vetëm pjesërisht kanë qasje në autostradë ndërsa janë taksapagues të barabartë me të gjithë qytetarët e Komunave të Kosovës që kanë nga dy, tri e katër kyçje në autostradë.

z. Nexhat Loku, Unë kam kërkuar qysh herët me u formua komisioni i Kuvendit të Komunës me i përcjellë punimet e autostradës nga kompania, "Bektel Enka". Punimet e autostradës përfunduan, ndërkaq asnjëherë nuk është bërë Raport nga kjo kompani për dëmet e shkaktuara gjatë ndërtimit autostradës, ndërkaq dëme të shkaktuara nga kompania gjatë punimeve ka shumë. Demet e shkaktuara nga autostrada nuk janë riparuar, është riparuar ndoshta një pjesë e vogël e dëmeve, por jo të gjitha. Në vazhdim të diskutimit z. Nexhat Loku i përmendi vendet në rrugët ku janë shkaktuar dëme nga kompania në fjalë të cilat dëme theksoj se nuk janë riparuar.

z. Ekrem Kyçyku, Si komunë jemi tejkaluar në formë totalisht sa i përket kyçje në autostradën " Arbën Xhaferi". Unë mendoj se ne si komunë duhet bërë trysni në nivel qendror- Ministrinë e linjës për realizimin e një kyçje- ç kyçje në qytetin e Kaçanikut.

z. Ekrem Raka, Të Fusha e Pajtimit është një kyçje-kyçje në autostradë, por ajo është bërë më tepër për shkak se në atë pjesë lidhet rruga për Tetovë dhe për Shtërpçë, ndërkaq nevojë me pasur një kyçje- ç kyçje qyteti i Kaçanikut në autostradë, kështu që unë e mbështeti Kërkesën për caktimin një takimi të përfaqësuesve të komunës me ministrin e Infrastrukturës.

Kryesuesi i Kuvendit, Si institucion, e kemi trajtuar këtë temë dhe e kemi adresuar një Kërkesë organeve relevante të nivelin qendror/ Çështja është se jemi angazhuar në këtë drejtim, ndërkaq e fundit është me dalë në rrugë dhe me protestuar. Vendimet për dy kyçje të reja për dy komuna të tjera janë marrë, dhe kur kanë pasur mundësi me u shtuar edhe këto dy kyçje, besoj se ka kohë ende edhe për komunën tonë. Sa i përket anës teknike, studimit të fizibilitetit etj. ato nuk na takojnë neve. Ajo që thuhet se nuk mund të lejojmë kyçje pa pasur një dokument nga qeveria, kujtoj se nuk është në rregull.

Kryetari i Komunës, Unë zyrtarisht nuk i kam bërë shkresë ish ministrit, z. Lutfi Zharku për një kyçje në autostradë, por në bisedime e sipër që kemi pasur, ai ka qenë i bindur se Kaçaniku nuk ka mundësi me pasur tjetër kyçje, kjo qysh ia kanë interpretuar ekspertët e fushës. Në nivel lokal, unë nuk e kam nivelin e inxhinierëve me qenë aq bindës se nuk ka mundësi me pasur qyteti një kyçje në autostradë. Ajo që e kam thënë unë në debat publik me qytetarë kur isha kandidat për kryetar komune, ka qenë, Kaçaniku po varroset me autostradën, ndërkaq nuk jam përkrahur nga masa përkundër së ishte fjala për një projekt madhor, por jam injoruar, ndërkaq së a kam pasur të drejtë, këtë po e tregon koha. Ministri aktual i infrastrukturës për kundër faktit se ka qenë në Komunën e Kaçanikut disa herë, nuk e ka ndier obligim të takohet me mua. Kërkesës suaj për lejimin e një kyçje ç kyçje i bashkëngjitem. Unë jam që çështjet të shkojnë në formë institucionale, ajo që na takon të mundohemi ta arrijmë. Unë jam bërë sa herë solidarë në kërkesat e arsyeshme të çdo komuniteti i cili ka dalë në rrugë dhe ka protestuar. Unë iu përkrahi në Kërkesën tuaj në cilën do formë që e aplikoni. Një Kërkesë iu drejtua Ministrisë së Infrastrukturës për këtë çështje, por nuk e kanë pa të arsyeshme me na u përgjigjur. Tani ndoshta është vonë, por

nuk është e pamundur, të drejtat tona duhet me i kërkuar në formë institucionale. Kur u realizua kjo çështje për dy komunat tjera, kjo të bënë më kuptuar se ka mundësi më u realizuar ende edhe për komunën tonë., sepse realisht jemi injoruar si komunë karshi dy komunave të tjera që iu lejua edhe nga një kyçje.

z. Selim Reka, Unë pajtohem më fjalën e Kryetarit të Komunës, Besim Ilazi se sa ka qenë në pushtet ministri, Lutfi Zharku, si komunë jemi përkrahur më shumë. Dihet se autostrada nga fillimi e deri tani ka kaluar nëpër tre ministra, dhe unë i kam bërë pyetje z. Zharku për një kyçje ç kyçje, mirëpo ai me ka thënë së për shkak të konfiguracionit të terrenit të Kaçanikut, është problem kjo me u realizuar. Edhe LDK e përkrahi kërkesën për lejjimin e një kyçje -ç kyçje në autostradë, ndërkaq si komunë, na mbetet të konsultohemi me ekspertë të fushës lidhur me vendin.

z. Bekim Koxha, Paraprakisht kur kemi biseduar me zëvendësministrin, Fatmir Lima, ai e ka shprehur vullnetin e tij me na përkrahur. Mirëpo kur Bektel Enka kërkoj edhe 53 milionë shtesë, atëherë z. Lima është tërhequr. Nëse ne qëndrojmë më kërkesën tonë, unë jam i bindur se zëvendësministri Lima do t'na përkrahë.

z. Ekrem Raka, Teknikisht nuk diskutohet, sepse është e mundur ndërtimi i një kyçje ç kyçje në autostradë në afërsi të qytetit të Kaçanikut, sepse ekziston mundësia me u lidhur me ura, mirëpo kuptohet së kjo është më e kushtueshme.

znj. Lirije Luta, I përkrahi mendimet e parafolësve të mi, ky është problem i nivelit qendror, kështu që edhe ne duhet me u vetëdijesuar që mos me iu dhënë vota kandidatëve për deputet kur t'i kërkojnë votat. Çështja lidhur me lokacionin dhe projektin, nuk na takon neve, ajo është çështje e nivelit qendror.

Kryesuesi i Kuvendit, Kur dy qyteteve tjera iu ka lejuar nga një kyçje, atëherë mendoj se kemi ende kohë. Si grupe parlamentare të ulemi e të bëjmë një Kërkesë, dhe t'i shfrytëzojmë edhe mekanizmat tjerë për me ndikuar me u realizuar kërkesa jonë.

z. Ekrem Raka, Grupet parlamentare të Kuvendit të Komunës e kanë kryer punën e vet. Mundesh Kryesues në emër të KK më e përcjellë një Kërkesë tek organeve relevante për çështjen e lejjimit të një kyçje ç kyçje të qytetit të Kaçanikut në autostradën "Arben Xhaferi".

Kryesuesi i Kuvendit, Unë jam për atë që Kërkesa të bëhet në emër të përfaqësuesve të subjekteve politike të komunës. Atëherë nëse nuk ka kush diçka, këtë çështje e shtroj në votim për aprovim. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës vendosi që, Në emër të grupeve parlamentare të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të bëjë një,

Kërkesë Ministrin të Infrastrukturës, Pal Lekaj

Për caktimin e një takimi me shefat e grupeve parlamentare të Kuvendit të Komunës për lejjimin e një kyçje -ç kyçje të qytetit të Kaçanikut në autostradën Prishtinë Shkup- autostrada, "Arbën Xhaferi".

Kërkesa e hartuar është regjistruar me numër të Protokollit, 01Nr. 104/02-19951/19.

Kryesuesi i Kuvendit. Përgjegjësinë e merr SHIL. Meqë nuk ka diskutime të tjera, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri nga anëtarët që ishin prezent. Adnan Reka nuk ishte prezent kur u votua kjo çështje. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë.

VENDIM

Për lejimin e qëndrimit pa pagesë të masës drusore dhe automjeteve të konfiskuara në Autoparkun e SHIL. / Lënda: 01Nr. 08-320/01-18621/19.

Detajet të cilat nuk i përcakton ky vendim, rregullohen me Marrëveshje në mes të Kryetarit të Komunës dhe SHIL.

8. Propozim Vendimi për formimin e Komisionit të Ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim.

Kryesuesi i Kuvendit. Sqaroj së me Ligjin e ri për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës, duhet të formohet Komisioni i Ankesave në përbërje prej 5 anëtarëve, 2 nga KK, 2 anëtarë nga Ekzekutivi dhe 1 anëtar nga OJQ. Nëse nuk ka kush diçka, atëherë nga KK shkojmë me propozime konkrete për dy anëtarë nga subjektet politike me të mëdha, PDK dhe LVV.

z. Nexhat Loku, Nga PDK e propozoj për anëtar komisioni, Vlora Dalloshi.

z. Ekrem Kyçyku, nga LVV e propozoj për anëtar të komisionit, Shpend Krusha.

Nga OJQ Kryesuesi e njoftoj KK së është sjellë propozimi nga forumi i OJQ, ashtu që është propozuar, Milazim Salijaj, gjeometër, ndërkaq dy anëtarët nga Ekzekutivi i Komunës i cakton Kryetari i Komunës.

Meqë nuk ka kush diçka, atëherë propozimet që dolën i shtroj në votim për aprovim dhe të njëjtat u aprovuan njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit të Ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim, në përbërje prej 5 anëtarëve ;

1. Vlora Dalloshi, anëtare nga PDK,
2. Shpend Krusha, anëtar nga LVV,
3. Një anëtar ekzekutivi i Komunës, caktohet nga Kryetari i Komunës,
4. Një anëtar nga ekzekutivi i komunës, caktohet nga Kryetari i Komunës dhe
5. Milazim Salijaj, nga OJQ- gjeometër privat.

Lënda: 01Nr. 104/02-18863/19.

Nga Ekzekutivi i Komunës, Kryetari i Komunës, për anëtarë të Komisionit të Ankesave i ka caktuar, **Zekeria Koxha dhe Mentor Shehu.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu në ora: 13:55 Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj mbledhjen të përfunduar. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 23 anëtarë, 1 anëtarë ka munguar me arsye gjatë tërë mbledhjes, ndërkaq me herët kanë dalë nga mbledhja 3 anëtarët: Vlora Dalloshi, Hamid Guri dhe Albana Troni.

Procesmbajtës

Makjire Malsiu

Malsiu



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2017);

nga Mbledhja e VI (Gjashtë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2019, mbajtur me 28.06.2019.

1. Kemal Mërseli.....,_____,
2. Hamid Guri.....,_____,
3. Ahmet Luma ,_____,
4. Kadri Krivenjeva,..... ,_____,
5. Besim Vishi,.....,_____,
6. Sali Malsiu.....,_____,
7. Lirije Shurdhani.....,_____,
8. Pranverë Loku- Zharku..... ,_____,
9. Lirije Luta.....,_____,
10. Vlora Dalloshi.....,_____,
11. Nexhat Loku ,_____,
12. Shpend Krusha..... ,_____,
13. Adnan Reka..... ,_____,
14. Ekrem Kyçyku.....,_____,
15. Fatijona Kyçyku..... ,_____,
16. Kaltrina Tafili ,_____,
17. Selim Reka.....,_____,
18. Besnik Salihu,..... ,_____,
19. Nazife Krasniqi..... ,_____,
20. Arlinda Rakoci-Raka..... ,_____,
21. Shemsedin Luzha.....,_____,
22. Albana Troni.....,_____,
23. Afërdita Shehi,.....,_____,
24. Hajredin Luta.....,_____,
25. Hafize Sallahi ,_____,
26. Bekim Koxha.....,_____,
27. Ekrem Raka,.....,_____,



Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 29. 07. 2019

Për: Anëtarët e Kuvendit: **znj. Nazife Krasniqi**
znj. Arlinda Rakoci-Raka
z. Bekim Koxha

Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruara para Kuvendit të Komunës, më datë 28. 06. 2019, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Emergjencave dhe Shërbimeve Publike.

znj. Nazife Krasniqi,

Pyetje për DSHPE; Sa jeni të përgatitur për temperaturat e larta të cilët pritet të mbretërojnë sivjet? A ka ndonjë Plan për çështjen e menaxhimit të zjarreve nëse paraqiten raste? Cilat janë veprimet të cilat do të merren për mungesën e ujit të pijes? A jeni të përgatitur për çështjen e parkingjeve, kur dihet se tani në këtë sezone shtohet numri i popullatës me ardhjen e bashkatdhetarëve?

- *Njësia e Zjarrëfiksëve dhe Shpëtimit është e paisur me automjete dhe staf profesionist dhe e gatshme për të reaguar në situata emergjente që paraqiten gjatë periudhës verore kur paraqiten zjarre të shumta. DESHP-ja në vazhdimësi, përmes njoftimeve publike merr masa preventive rreth informimit të qytetarëve për masat parandaluese të zjarreve që mund të paraqiten në temperatura të larta.*
- *KRU "Bifurkacioni"-njësia operative në Kaçanik raporton në vazhdimësi rreth gjendjes me furnizim të ujit të pijshëm. Aktualisht probleme kemi me furnizim të rregullt në fshatrat Kaçanik i Vjetër dhe Begracë shkaku i prishjes së pompës furnizuese kurse në pjesët tjera nuk kemi probleme të theksuara. Janë inspektuar shumica e lokaleve afariste, ku iu është kërkuar shfrytëzim sa më racional të ujit dhe vërejtje për shkak të ujitjes së verandave para lokaleve.*
- *Krahas parkingjeve aktuale që ekzistojnë në zonën urbane të qytetit janë lejuar edhe hapësira te Kalaja e qytetit, stacioni i autobusëve dhe së fundmi është lejuar nga drejtoria e arsimit edhe hapësira e oborrin të shkollës "Emin Duraku", të cilat do të zbusin në një masë nevojën për parkim të automjeteve gjatë periudhës kur janë bashkatdhetarët.*

Znj. Arlinda Rakoci-Raka, Kam një Kërkesë për DSHPE lidhur me pllakën të Shtëpia e Kulturës, e cila pllakë ka gabime teknike dhe e njëjta duhet të përmirësohet. Në pllakë është shënuar "Shtëpia: ndërkaq duhet të jetë, "Shtëpia".

- *Drejtoria e Shërbimeve Publike, pas lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik për projektin "Rregullimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimit vertikal dhe horizontal"-*

planifikon që të bëjë rregullimin e të gjitha shenjave të komunikacionit të dëmtuara, ato me gabime eventuale teknike etj. dhe vendosjen e te rejave sipas planifikimeve paraprake të drejtorisë.


- **z. Bekim Koxha,**

Pse nuk ka ujë në ujësjellësin e f. Doganaj, ndërkaq në f. Elezaj nga vjen drejtori ka ujë. Ka shqetësime se drejtori manipulon me çështjen e ujësjellësit.

- *Projekti “Sanimi, rekostruimi dhe shtimi i kapaciteteve ujore në sistemin e ujësjellësit Dubrave-Doganaj-Elezaj”-projekt i financuar dhe mbikëqyrur nga MMPH-ja është në fazën përfundimtare të saj. Janë duke u bërë testime të rrjeteve të ujësjellësit sipas projektit në lagjet e këtyre lokaliteteve.*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!

Me respekt,


Ramadush Osmani
Drejtor i DSHPE-së